



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS - TUZILAKI SAJETA KOSOVA SEKRETARIATI - SEKRETARIJAT ARKIVA - ARHIVA		
Pranuar 01-06-2022 Priljeno		
Numri rendor Redni broj	Ora e pranimit Ças prijema	Nenshkrimiti pranuesit Potpis primaoca
911		

A.A.nr.6/2022

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: [REDAKTUAR] kryetar i kolegjit, [REDAKTUAR] anëtar të kolegjit, në çështjen disiplinore, ndaj Musli Gashi, Prokuror në Prokurorinë Themelore në Prizren, kundër Këshillit Prokurorial të Kosovës në Prishtinë (KPK), për shkak të shqiptimit të masës disiplinore, duke vendosur në procedurën e ankesës kundër vendimit të KPK-së, nr.510/2022, të datës 14 prill 2022, në seancë të kolegjit të mbajtur më datë 30.05.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e paraqitur nga Musli Gashi, Prokuror në Prokurorinë Themelore në Prizren, ndërsa vendimi i Këshillit Prokurorial të Kosovës në Prishtinë, KPK . nr.510/2022, i datës 14 prill 2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Këshilli Prokurorial i Kosovës në Prishtinë (KPK), me vendimin KPK.nr.510/2022, të datës 14 prill 2022, në pikën I të dispozitivit ka vendosur: Aprovohet Raporti i plotësuar i panelit hetimor AD.nr. 06/2021 i datës 18 mars 2022 në rastin disiplinor të prokurorit Musli Gashi, Prokuroria Themelore në Prizren. Në pikën II të dispozitivit është vërtetuar se prokurori Musli Gashi ka vepruar në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Ndërsa në pikën III të dispozitivit prokurorit Musli Gashi i shqiptohet sanksioni disiplinor, Vërejtje Publike me shkrim, sipas nenit 7 paragrafi 1 pika 1.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Kundër këtij vendimi prokurori në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar vendimin për shkak të zbatimit të gabuar të Ligjit për Prokurorin e Shtetit (Ligji nr.03/1-



225), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.03/L-034 dhe për shkak shkeljeve procedurale të përcaktuara me Rregulloren nr.05/2019, për procedurën disiplinore të prokurorëve si dhe Ligjit për Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me propozim që: Gjykata e Supreme e Kosovës ankesën e subjektit hetimor ta aprovoj dhe ta ndryshoj vendimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK. nr.510/2022, të datës 04 prill 2022, duke e liruar atë nga përgjegjësia disiplinore.

Me përgjigje në ankesë, KPK ka propozuar që ankesa e paraqitur të refuzohet ndërsa vendimi i atakuar të mbetet në fuqi.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me vendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 15, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka gjetur se:

Ankesa e prokurorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se KPK, më datë 06 dhjetor 2021, ka pranuar kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor nga Autoriteti Kompetent me pretendimin se Musli Gashi – prokuror në Prokurorinë Themelore në Prizren, mund të ketë kryer shkelje disiplinore nga neni 6, paragrafi 2, pika 2.2 dhe 2.6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Autoriteti Kompetent ka kërkuar nga KPK, si organ kompetent të filloj hetimin disiplinor dhe ka propozuar që ndaj të njëjtit të shqiptohet sanksioni disiplinorë vërejtje publike me shkrim e përcaktuar me nenin 7, par.1. pika 1.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Kërkesës së lartcekur, Autoriteti Kompetent ia ka bashkangjitur shkresat e lëndës me shenjë [REDAKTUAR], në të cilat pretendon se veprimet e prokurorit nuk kanë qenë profesionale dhe konform dispozitave të Kodit të Procedurës Penale ngase aktakuza nuk është hartuar konform gjendjes faktike dhe provave të siguruara gjatë hetimit.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, me vendimin KPK-Nr.945/2021, të datës 28 dhjetor 2021, ka themeluar Panelin Hetimor për lëndën disiplinore AD.nr.06/2021. Paneli Hetimor më datën 24.02.2022 i ka paraqitur KPK-së, raportin me shkrim lidhur me hetimin e bërë për shkeljen e pretenduar.

Pas pranimit të raportit nga Paneli Hetimor, KPK-ja, për të shqyrtuar këtë çështje disiplinore më datë 15.02.2022, ka mbajtur seancën dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë kryesuesi i panelit hetimor dhe subjekti i hetimit disiplinor, mirëpo gjatë kësaj seance raporti i është kthyer panelit hetimor ngase subjekti i hetimit ka deklaruar se çdo veprim që e ka ndërmarr në këtë rast është konsultuar me kryeprokurorin dhe është kërkuar që



të vërtetohet nëse prokurori është konsultuar me kryeprokurorin për mos përfshirjen e këtyre fakteve në dispozitiv të aktakuzës.

Paneli Hetimor ka mbajtur serish seancë dëgjimore në të cilën është bërë ballafaqimi i subjektit të hetimit dhe kryeprokurorit- autoritetit kompetent për inicim të rastit hetimor, ku në bazë të provave të paraqitura, fakteve të konstatuara, ballafaqimit të palëve, paneli nxjerr përfundimin se prokurori Musli Gashi ka përgjegjësi disiplinore për shkak të shkeljeve nga neni 6 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2. të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sepse me rastin e përshkrimit të gjendjes faktike në dispozitivin e aktakuzës nuk ka marr parasysh provat dhe faktet fajësuese dhe shfajësuese gjatë hetimit të krimit se viktimi ishte e ndjeshme dhe se viktimi ishte goditur më mjet të fortë prehës. Nga këto arsye, Paneli Hetimor ka propozuar që të aprovohet propozimi i Autoritetit Përgjegjës - Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren që ndaj subjektit të hetimit - prokurorit Musli Gashi të shqiptohet masa disiplinore Vërejtje Publike me Shkrim.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, pas shqyrtimit të raportit plotësues të panelit, dëgjimit të kryesuesit të panelit dhe subjektit të hetimit si dhe pas vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës ka nxjerrë vendimin e atakuar KPK.nr.510/2022, i datës 14 prill 2022, me të cilin është konstatuar se prokurori Musli Gashi është shpallur përgjegjës për shkelje disiplinore dhe i është shqiptuar sanksioni disiplinor duke vendosur më decidivishtë si në dispozitiv të vendimit të atakuar.

Në arsyetim të vendimit të atakuar, KPK ka theksuar se: pas vlerësimit të provave të administruara dhe deklaratës së subjektit të hetimit në vazhdimin e seancës dëgjimore të mbajtur më datën 14 prill 2022, ka konstatuar se prokurori Musli Gashi, me rastin e ngritjes së aktakuzës në rastin [REDACTED] ka kryer shkelje disiplinore të përcaktuar me nenin 6 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

KPK, ka konstatuar se prokurori Musli Gashi është përfshirë në shkelje disiplinore të pretenduar nga autoriteti kompetent, për shkak se ka trajtuar rastin [REDACTED] me lëshime serioze me rastin e ngritjes së aktakuzës duke mos e përfshirë në dispozitiv viktimën e ndjeshme të miturit dhe mjetin e fort jo të prehtë me të cilin është goditur viktimi e ndjeshme. Nisur edhe nga provat që i ka pasur në dispozicion si mendimin e ekspertit, certifikatën e lindjes së të miturit, pranimin e të pandehurit që e ka goditur me mjet të fort dhe procesverbalin e marrjes në pyetje të miturit, përcaktojnë saktë shkelje në përshkrim të gjendjes faktike në dispozitivin e aktakuzës. Sipas Këshillit Prokurorial të Kosovës, arsyetimi i prokurorit Musli Gashi se mund të jetë lëshim por i pa qëllimshëm dhe jo fshehtë të fakteve, nuk paraqet bazë për të përjashtuar përgjegjësinë disiplinore sepse si prokuror i çështjes ka qenë i detyruar që saktësisht dhe tërësisht t'i



konstatohet faktet në aktakuzë e të cilat janë vendimtare për marrjen e një vendimi të ligjshëm dhe të drejtë. Më tej KPK konstaton se përkundër kërkesës së kryeprokurorit që të evitohen gabimet në aktakuzë, subjekti i hetimit nuk i bindet kërkesës së epërorit por e bënë përmirësimin vetëm pasi një gjë të tillë e kërkon Gjykata duke kthyer aktakuzën në plotësim dhe rikualifikim.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të vendimit të atakuar KPK, ju ka referuar nenit 7 par.1 pika 1.2 dhe nenit 6 par.2 nënpar.2.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Gjykata Supreme e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i Këshillit Prokurorial të Kosovës është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që vendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, drejt dhe në mënyrë plotë është vërtetuar gjendja faktike, si dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera, të cilat i ka pretenduar pala ankuuese me ankesë.

Subjekti hetimor në ankesën e paraqitur pretendon se KPK ka zbatuar gabimisht Ligjin për Prokurorin e Shtetit (Ligji nr.03/I-225), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.03/L-034. Gjykata Supreme vlerëson se një pretendim i tillë është i gabuar ngase subjekti i hetimit nuk është shpallur përgjegjës për shkelje të detyrave të tij në lidhje me atë kur prokurori nuk vepron në përputhje me vendimet apo udhëzimet e ligjshme të prokurorit, por në këtë rast subjekti i hetimit është gjet si përgjegjës për shkelje që ka të bëjë me atë se gjatë trajtimit të rastit - përshkrimit të gjendjes faktike në dispozitivin e aktakuzës nuk ka marr parasysh provat dhe faktet fajësuese dhe shfajësuese se viktima ishte e ndjeshme dhe së viktima ishte goditur më mjet të fortë prehës.

Gjykata vlerëson se e-maili të cilin kryeprokurori ia ka dërguar subjektit të hetimit nuk mund të trajtohet si udhëzim i natyrës së tillë për të ndërhyrë në pavarësinë funksionale dhe profesionale të prokurorit, por ka qenë njoftim për prokurorin e rastit përmes të cilit janë vënë në pah lëshimet të cilat janë vërejtur në përpilimin e aktakuzës. Pra, përmes e-mailit, prokurori i rastit është vënë në dijeni të fakteve dhe provave që kanë të bëjnë me viktimën e ndjeshme dhe mjetit që është përdorë në kryerjen e veprës penale, të cilat është dashur të jenë pjesë e dispozitivit të aktakuzës, të cilat më vonë janë përmirësuar nga prokurori, por vetëm pas kërkesës së gjykatës kur i është kthyer prokurorit aktakuza në plotësim dhe rikualifikim.

Gjykata Supreme nuk ka pranuar as pretendimin ankimor për shkelje procedurale të përcaktuara me Rregulloren nr.05/2019, për procedurën disiplinore të prokurorëve si dhe Ligjin për Përgjegjësiën Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, kjo për faktin se kthimi i raportit në plotësim nga KPK nuk paraqet shkelje procedurale pasi që qëllimi i zhvillimit të procedurës është mbledhja e informacioneve të nevojshme me qëllim të



vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike dhe marrja e një vendimi të drejtë për palët në procedurë. Fakti që nuk ka ndonjë dispozitë ligjore që shprehimisht parasheh çështjen e kthimit të raportit në plotësim, kjo nuk nënkupton që organi shqyrtues i raportit nuk ka të drejtë ta bëjë këtë sa herë që gjatë procedurës konstatohet se është e nevojshme të bëhet një gjë e tillë, siç ka ndodh në këtë rast kur subjekti i hetimit ka konstatuar një fakt i cili është dashur të vërtetohet nga paneli hetimor përmes ballafaqimit të subjektit hetimor me kryeprokurorin e rastit- njëherit autoriteti kompetent që ka kërkuar fillimin e hetimit.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se Këshilli Prokurorial i Kosovës në bazë të provave të administruara në mënyrë të pa kontestuar e ka vërtetuar faktin se prokurori Musli Gashi është përfshirë në shkelje disiplinore të pretenduar nga autoriteti kompetent, për shkak se nga provat që i ka pasur në dispozicion si: mendimi i ekspertit mjeko ligjor, certifikatën e lindjes së të miturit, pranimin e të pandehurit që e ka goditur me mjet të fort dhe procesverbalin e marrjes në pyetje të miturit, rezulton se prokurori në fjalë në ngritjen e aktakuzës në rastin [REDACTED] ka bërë lëshime duke mos e përfshi në dispozitiv viktimën e ndjeshme të miturin dhe mjetin e fort jo të prehtë me të cilin është godit viktima e ndjeshme, të cilat kanë qenë vendimtare në cilësimin e juridik të drejtë të veprës penale. Mos marrja për bazë e këtyre fakteve nga prokurori i rastit, përkundër që ka qenë në dijeni të tyre gjatë trajtimit të rastit, pastaj vënia në dijeni të tyre nga kryeprokurori, si dhe evitimi i tyre pasi që një gjë e tillë është kërkuar nga gjykata, sipas vlerësimit edhe të kësaj gjykate paraqet shkelje të detyrave të prokurorit.

Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e KPK-së, për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, për arsye se me nenin 6 paragraf 2 nën paragraf 2.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, përcaktohet se: “*Shkelja e detyrave të prokurorit sipas këtij ligji, përfshin veprimet e mëposhtme, në qoftë se prokurori kryen me dashje apo nga pakujdesia e rëndë: nuk merr parasysh provat dhe faktet fajësuese dhe shfajësuese gjatë hetimit të krimit dhe nuk siguron që hetimi është zhvilluar në respektim të plotë të të drejtave të të pandehurit*”. Ndërsa me nenin 7 paragraf 1 të këtij ligji përcaktohet se: “*Për shkelje disiplinore, këshillat përkatës mund ti shqiptojnë gjyqtarëve dhe prokurorëve një ose më shumë nga sanksionet disiplinore në vijim: 1.1. vërejtje jopublike me shkrim; 1.2. vërejtje publike me shkrim; 1.3. zvogëlim i përkohshëm i pagës deri në 50% për një periudhë deri në një vit; 1.4. transferim i përkohshëm ose i përhershëm në një gjykatë apo prokurori tjetër të nivelit më të ultë; 1.5. propozim për shkarkim*”, ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se; “*Masa disiplinore shqiptohen vetëm në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe duke marr parasysh: 2.1. numrin dhe seriozitetin e shkeljeve disiplinore të kryera nga një gjyqtar apo prokuror; 2.2. pasojat e shkeljes disiplinore; 2.3. rrethanat në të cilat është kryer shkelja disiplinore; 2.4.*





GJYKATA SUPRËME E KOSOVËS

Sheji i shkresës AA - 6 / 2022
Oznaka spisa: 31. 5 / 2022

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS

(Të panevojshmeve bjeri vizë - nepotrebne precrtat)

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dashtë të bëhet dorëzimi i sa pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtësës, fqit, personit që punon po n'atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokusajo dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestjenja da radi dostavljanja bude u odredjeno vreme u svom stan u radnom mestu, dostava je izvršena; odraslom članu domaćin. Primaoca nastojniku zgrace susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pribieno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____
dana _____ u _____ cas.
Shkaku i refuzimit të marrjes _____
Razlog odbijanja prijmea _____

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljava

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

AKT GJYKIMJE C DT
30. 5. 2022

Numri i shtojcave: _____
broj priloga _____

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur
më (me fjalë)
Povrdujemo prijem gorenavëgenog pisma
(i slovima)

Bucurli 01.06.2022

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primaoca ili lica koje je
pismeno primilo u zameņu)

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljava

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shënuar shkaku për marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpis, potpisuje ga dostavljač, napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.